

Përmbledhje



GJYQTARI I GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC Z. ARTAN JAHOLLARI, PËRBALLET ME PROCESIN E RIVLERËSIMIT PRANË KPK DUKE U KONFIRMUAR NË DETYRË

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 07/12/2022 PRANË KPA:**

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLGJ dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Në të njëjtin përfundim kishte arritur edhe Komisioni, në përmbyllje të hetimit administrativ.

Komisioni ka shqyrtuar 2 denoncime të depozituara nga publiku gjatë vendimmarrjes.



Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec z. Artan Jahollari, përballat me procesin e rivlerësimit pranë KPK

Më datë 07.12.2022 ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Artan Jahollari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Trupa gjykuese përbëhej nga znj. Genta Tafa Bungo (Kryesuese), z. Lulzim Hamitaj (Relator) dhe znj. Valbona Sanxhaktari (Anëtare), si dhe u asistua nga vëzhguesja ndërkombëtare znj. Marie Tuma, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë seancës dëgjimore, u vërejt se subjekti nuk u përfaqësua nga ana e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe nuk paraqiti kërkesa paraprake apo proceduriale në lidhje me hetimin ose trupën gjykuese.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLGJ dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Në të njëjtin përfundim kishte arritur edhe Komisioni, në përmbyllje të hetimit administrativ.

Gjatë seancës dëgjimore, vëmendje mori shpjegimi nga ana e subjektit të rivlerësimit mbi ngatërresën lidhur me konceptin ‘person i lidhur’, në kuptim të nenit 3 pika 13 të ligjit nr. 84/2016. Kjo situatë ka bërë që subjekti i rivlerësimit të mos deklaronte si pasuri përdorimin e banesës së prindërve të tij, por ta pasqyronte vetëm si adresë. Në kuadër të kalimit të barrës së provës, subjekti ka provuar ekzistencën e pasurisë së paluajtshme.

Komisioni ka shqyrtuar 2 denoncime të depozituara nga publiku, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni do të vlerësonte këto denoncime përpara vendimmarrjes, por subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime shtesë në seancë

Të dy denocimet lidheshin me të njëjtin shtetas B.K. Në denoncimin e parë, nga ky shtetas është pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim mbi një çështje pasurie të paluajtshme pa arsyetuar të gjitha kërkesat e ankuesit. Vendim ky që është prishur më pas Gjykata e Apelit duke vendosur që të kryhen hetime të mëtejshme në terren. Prokuroria ka vendosur ta pushojë çështjen, sepse rezultatet dolën të njëjta me vendimin e shkallës së parë.

Denoncimi i dytë është paraqitur nga një ish anëtar i Këshillit Mbikqyrës të Bashkisë Pogradec, ku pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë në përgjegjësi penale vetëm anëtarët e Këshillit Mbikqyrës por jo përfituesin e veprimeve të paligjshme që në këtë rast është B.K (shtetasi që ka paraqitur denoncimin e parë). Për të provuar se nuk e kishte favorizuar B.K, z. Jahollari ka dorëzuar para Komisionit një tjetër vendim, ku ky individ ka humbur një gjyq me vlerë të konsiderueshme.

Komisioni në seancën për shpalljen e vendimit përcaktuar në datë 09.12.2022 vendosi konfirmimin në detyrë të gjyqtarit z. Artan Jahollari.